Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Bashkia Korçë

2005

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis

Bashkia Korçë

2005

Përgatitja e këtij dokumenti është financuar nga:

Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA)

Opinionet e shprehura në këtë dokument nuk paraqesin domosdoshmërisht opinionet e Sida.
Përgjegjësia për to mbetet e autorëve

Me mbështetjen e:

Qendra Rajonale e Mjedisit
Shqipëri

Në përgatitjen e këtij plani kanë kontribuar:
Stafi i Bashkisë Korçë, Shoqata "Gruaja Korçare", Shoqata "Zhvillimi dhe Mbrojtja e Ekosistemeve", Shoqata "Natyra Ndërkufitare", Shoqata "Morava", si dhe **Albana Çule, Pirro Pine, Roland Lalaj** (Drejtoria e Higjenes), Senja Biça (Drejtoria e Gjelbërimit), Zhaneta Pepo, Leonard Gjançi (Bashkia Korçë), Eleina Qirici (Universiteti i Korçës), Stavri Pllaha, Klara Çelo, Besnik Mançelli, Mihallaq Qirjo, Koço Kërëku.

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)
Shqipëri
është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse që mbështet zgjidhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore e Lindore, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve e aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore. REC është krijuar në 1990 nga ShBA, Komisioni Evropian dhe Hungaria.

Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e tij, nënshkruar nga 28 vende dhe Komisioni Evropian, dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 15 vendeve përfituese.

Shqipëria e ka nënshkruar Kartën e REC në 1993. Zyra e REC për Shqipërinë është hapur në 1994.

Kjo zyrë punon për realizimin e misionit të REC duke mbështetur organizatat jofitimprurëse, institucionet mjedisore në të gjitha nivelet dhe aktorë të tjerë të interesuar në fushën e mjedisit, duke mbështetur proceset pjesëmarrëse e shkëmbimin e lirë të informacionit. Fushat kryesore të veprimtarisë janë: Programi i granteve për OJF-të; Planet Lokale të Veprimit në Mjedis, Informacioni Mjedisor; Edukimi Mjedisor; Programi i kualifikimit për OJF-të dhe zyrtarë të mjedisit, nismat dhe programet vendore e rajonale; etj.

Donatorët më të fundit janë: Komisioni Evropian, Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, SIDA, UNDP, GEF/SGP, Fondacioni SOROS, SDC, etj.

Adresa: Rr. Ismail Qemali, Nr.27, Kutia Postare 127, Tiranë
E-mail: rec@albania.rec.org
Adresa e internetit: http://albania.rec.org

Design: Eduart Cani; Shtypi:

Parathënie

Qyteti i Korçës, si djep i kulturës dhe edukimit, ka zotëruar për vite e vite një edukatë qytetare të lartë përsa i përket pastërtisë, dashurisë mbi natyrën dhe edukimin e brezave mbi çështjet e mjedisit, gjë që e dallon Korçën nga qytetet e tjera të Shqipërisë.

Gjatë viteve të fundit, ashtu si dhe në të gjithë vendin, qyteti i Korçës u përball me probleme të ndryshme si lëvizja e popullsisë, rritja e kërkesës për investime në infrastrukturë, rritja e kërkesës së biznesit për çeljen e aktiviteteve të reja prodhuese, vështirësi ekonomike për të përballuar kërkesat e kohës për investime publike etj. Këto u shoqëruan me shqetësime mjedisore të cilavet iu shtuan edhe ato që lindën pas mbylljes së një sërë investimesh madhore në qytet.

Përballë këtyre problemeve, qyteti u dëmtua në pjesë të ndryshme të tij, si rezultat i mungesës së infrastrukturës bazë për pastrimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e zonave të ndryshme të qytetit.

Megjithatë, angazhimi qytetar dhe dashamirësia e banorëve të qytetit mbetet në nivelet më të larta në rang kombëtar. Për këtë arsye, qyteti i Korçës mbetet qyteti i parë nën vëmendjen e të gjithë donatorëve që mbështesin nivelet vendore dhe kombëtare.

Në këtë frymë, qyteti i Korçës është i pari, që po punon për ndërtimin e rrjetit të ri të kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të bardha, shoqëruar me impiant pastrimi, dhe, së shpejti, do të jetë pjesë e një projekti rajonal (i pari në rang vendi) për menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane dhe ndërtimin e një fushe sanitare për grumbullimin dhe përpunimin e tyre.

Nga donatorët më të fuqishëm për qytetin e Korçës ka qenë dhe mbetet KfW dhe SIDA. Kjo e fundit ka dhënë kontribut shumë të lartë për çështjet e mjedisit, pjesë e të cilit është dhe ky dokument strategjik pune, i cili ishte fryt i mbështetjes së dhënë nga REC Shqipëri, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë dhe me specialistë vendorë.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është një dokument pune, i cili pritet të shërbejë si hap i parë i thithjes së investimeve për përmirësimin e mjedisit në qytetin e Korçës, për 10 vitet e ardhshme. Ky dokument do t'iu sherbejë të gjithë aktorëve vendorë dhe qendrorë për fokusimin e investimeve të tyre në fushën e mjedisit për qytetin tonë.

Në mbyllje të kësaj përshëndetje, dua të falënderoj SIDA dhe REC Shqipëri për kontributin e vazhduar që kanë dhënë dhe japin për qytetin e Korçës.

Z. Robert Damo
Kryetari i Bashkisë Korçë

Përmbajtja

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis 9

Vizioni i qytetit të Korçës 11

Hyrje 13
- Pozicioni gjeografik
- Historiku i qytetit
- Popullsia

I. Zhvillimi urban 15
- I.1 Rrjeti i kanalizimeve
- I.2 Mbetjet e ngurta
- I.3 Parqet, lulishtet, gjelbërimi i rrugëve
- I.3 Cilësia e ajrit

II Zhvillimi ekonomik 19

III. Arsimi dhe edukimi mjedisor 20

V. Mundësitë për pushim dhe turizëm 21

IV. Trashëgimia kulturore 22

Problemet mjedisore 25

Plani i Veprimit 41

Shtojcat 55

Procesi i hartimit të Planit Lokal të Veprimit në Mjedis

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Qytetin e Korçës u hartua përgjatë një periudhe njëvjeçare dhe në hartimin e tij u përfshinë të gjithë aktorët vendorë dhe komuniteti i qytetit. Për këtë u ngrit një grup pune më specialistë të fushave të ndryshme (urbanistikë, turizëm, shëndetësi, arsim, zonat e gjelbra, trashëgimi kulturore, etj), të cilët punuan në bashkëpunim me specialistë të tjerë të qytetit për hartimin e PLVM.

Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të thithur mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar një sërë takimesh me OJFtë vendase dhe me publikun, gjatë të cilëve janë paraqitur gjetjet e grupit të punës dhe janë diskutuar problemet mjedisore të qytetit të Korçës. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar rolit të gruas në proceset e përgatitjes dhe zbatimit të politikave dhe planeve të zhvillimit, në kuadër të së cilës janë organizuar takime specifike me gra profesioniste dhe banore të thjeshta të qytetit për të përfshirë opinionet dhe kontributin e tyre në këtë plan mjedisor.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis do t'i shërbejë Bashkisë së Korçës si dokument pune për hartimin dhe planifikimin e nismave mjedisore në qytet. Dokumenti i është paraqitur Këshillit Bashkiak të Qytetit të Korçës dhe është miratuar prej tij më 06 Nëntor 2005, duke e kthyer atë në një dokument zyrtar pune. Për të ndihmuar procesin e zbatimit, një shumë investimesh të akorduara nga projekti do të përdoren për të zbatuar pjesë të Planit.

Dokumenti është i hartuar në tre pjesë:

i) analiza e situatës

Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë qytetin e Korçës.

ii) lista e problemeve mjedisore

Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe prioriteti për secilin.

iii) plani i veprimeve për zgjidhje

Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara. Kjo matricë u shërben autoriteteve vendore për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

Hapat e hartimit

Aktiviteti	Periudha
Marrja e angazhimit nga Bashkia Korçë	Mars 2004
Takim i hapur për fillimin e punës	Prill 2004
Ngritja e grupit të punës me ekspertë lokalë	Maj 2004
Trajnimi i grupit të punës	Maj 2004
Faza e parë e procesit - Analiza e situatës mjedisore	Qershor – Shtator 2004
Faza e dytë e procesit - Përgatitja e listës së problemeve	Tetor – Nëntor 2004
Takime me OJFtë mjedisore dhe të grave në qytet	Dhjetor 2004
Faza e tretë e projektit - Përgatitja e planit të veprimeve	Dhjetor 2004 – Janar 2005
Takime me OJFtë mjedisore dhe të grave në qytet	Shkurt 2005
Takim i hapur në Bashkinë Korçë për materialin paraprak	Mars 2005
Përfundimi i dokumentit	Prill 2005
Miratimi i Planit nga Këshilli Bashkiak	Nëntor 2005

VIZIONI

Korça qendër urbane, ku ruhet tradita dhe zhvillohet e përparuara, me kulturë tradicionale dhe zhvillim bashkëkohor të arsimit, me qendra universitare të përparuara, me zhvillim të industrisë agro-përpunuese; një qytet që rritet, me infrastrukturë të përparuar dhe me mbrojtje mjedisore, që mirëpret investitorë vendas dhe të huaj me zhvillim të pandërprerë të harmonisë së komuniteteve, në përputhje me strategjinë kombëtare dhe tendencat e zhvillimit global.

VENDNDODHJA

Pasaporta e qytetit

Emri	Korçë
Lindja	600 vjet p.e.s
Pozicioni gjeografik	Në jugindje të Shqipërisë
Popullsia	84000 banorë
Lartësia	+ 850 m mbi nivelin e detit

Hyrje

Pozicioni gjeografik

Qyteti i Korçës është një nga qendrat më të mëdha dhe më të rëndësishme të zonës juglindore të Shqipërisë.

Korça karakterizohet nga një klimë kontinentale, me dimër të ftohtë dhe me verë të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore arrin deri në 10,6 ^{0}C. Muaji më i ftohtë është Janari dhe muaji më i nxehtë është Gushti. Muaji më i lagësht është Nëntori me reshje shiu mesatarisht 104,9mm.

Qyteti i Korçës është i vendosur në një lartësi prej 850 m mbi nivelin e detit dhe është një nga qytetet me vendndodhjen mesatare më të lartë në Shqipëri. Korça, si rajon, është e rrethuar nga një numër i konsiderueshëm kodrash dhe malesh. Në lindje qyteti kufizohet me malin e Moravës dhe në perëndim me zonën e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, të cilat janë zonat më malore. Në jug ndodhet Mali i Qarrit dhe në pjesën veriore është Mali i Thatë. Zona e Korçës është e pasur me burime nënujore, lumenj, ku më i rëndësishëm është lumi i Devollit. Në këtë zonë gjenden burimet e tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum).

Historiku i qytetit

Pozicioni dhe konfigurimi gjeografik si dhe klima e favorshme kanë ndikuar që Korça të konsiderohej si një nga qendrat më të admirueshme, duke filluar që nga periudha prehistorike, gati 6.000 vjet para erës sonë.

Nga pikëpamja ekonomike, Korça ka qenë një nga qendrat më të rëndësishme të rajonit, nga ku zhvillohej tregtia e prodhimeve bujqësore me vendet e tjera. Çelësi i zhvillimit ekonomik të qytetit të Korçës ka qenë pazari i saj, ku njerëzit mund të gjenin me lehtësi punime dore të ndryshme dhe prodhime bujqësore. Në pazarin e Korçës kanë ekzistuar rreth 1.000 dyqane të ndryshme deri nga mesi i shek. 19.

Gjatë shekullit të 19-të, popullsia e qytetit të Korçës u rrit nga 3.000 në 15.000 banorë të ndarë në 14 lagje. Në vitin 1870, Korça u bë Prefekturë, e cila kishte nën juridiksion Bilishtin, Kolonjën dhe Kosturin.

Gjysma e parë e shek. 20 shënoi një zhvillim të madh dhe të shpejtë për Korçën, ku u ndërtuan godina të reja gjatë viteve '20-'30. Në vitin 1923, u hap Fabrika e duhanit, në periudhën 1925-'26 u ndërtuan më shumë se 200 dyqane, u hapën Kinema Luks (1926) e më pas Kinema Majestik, Fabrika e lëkurës (1929), etj. Në vitin 1923, Korça kishte një popullsi prej 25.598 banorë.

Popullsia

Popullsia e qytetit të Korçës për vitin 2004, numëronte rreth 84.000 banorë, me një ndarje pothuajse të njëjtë të femrave dhe meshkujve. Në një analizë të vitit 2004, vihet re që numri popullsisë "hyrëse" në qytet është më i madh se ai "dalëse". Kjo tregon për një tendencë shtimi të qytetit, me gjithë rënien e menjëhershme që pësoi pas vitit '90 prej migrimit brenda vendit dhe jashtë shtetit të shumë familjeve korçare.

Tabela 1. Lëvizja e popullsisë banuese të qytetit të Korçës për vitin 2004

Fillim viti	Nga kjo		Shtesat				Pakësimet				Total	Nr. Familje
			Të lindur		Të ardhur		Të vdekur		Të shpërngulur			
2004	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F		
84.000	40.613	43.387	291	254	560	1.016	281	217	160	439	85.024	27,077

I. Zhvillimi urban

Qyteti i Korçës shtrihet në rrëzë të Malit të Moravës dhe të kodrave përreth tij. Sipërfaqja e qytetit brenda vijës së verdhë, sipas Planit Rregullues të qytetit të Korçës, të miratuar me vendim të KRRTSH-së Nr 3, datë 04.02.1994, është 1.530 ha, në shtrirje veri-jug 5,4 km dhe lindje-perëndim 3,2 km.

Pjesa më e madhe e ndërtimeve janë ndërtime të ulëta deri në tri kate, ndërsa zona me ndërtime relativisht të larta shtrihet përreth lagjeve të vjetra të qytetit. Maksimumi i lartësisë në ndërtimet e reja arrin në 10-11 kate. Brenda qytetit të Korçës ka 345.000 m^2 rrugë, nga të cilat 120.000 m^2 janë rrugë të asfaltuara dhe 225.000 m^2 janë rrugë të paasfaltuara. Pjesa më e madhe e zonës ekzistuese së banimit shtrihet në terren me pjerrësi në drejtimin lindje-perëndim duke kaluar në fushë në pjesën perëndimore, ku është parashikuar shtrirja e qytetit edhe në perspektivë. Në këtë pjesë përfshihet një sipërfaqe e madhe toke bujqësore e destinuar për t'u kthyer në truall ndërtimi. Një pjesë e saj është zënë me ndërtime pa leje në zona pa asnjë lloj infrastrukture, kryesisht nga popullsia fshatare që vendoset në qytet, pasi edhe kostoja e ndërtimit në këto zona është relativisht më e ulët se kostoja e ndërtimeve në zonat me pjerrësi. Për këtë arsye, është ruajtur peizazhi i qytetit në lidhje me kodrat.

Ndryshimet e mëdha sociale të ndodhura në Shqipëri në periudhën e fundit, e gjetën të papërgatitur qytetin nga ana urbanistike, gjë që solli rritjen e problematikës lidhur me zhvillimin urban të qytetit. Kështu, nga një zhvillim i planifikuar dhe i mbajtur gjithmonë nën kontroll, ky zhvillim urban filloi të dalë nga kontrolli në përmasa të pallogaritshme.

Një nga arsyet kryesore ka qenë lëvizja e lirë e njerëzve, e cila solli si pasojë dyndjen e njerëzve nëpër qytete, të cilët, për të siguruar kushtet e nevojshme të jetesës, kryen ndërtime të jashtëligjshme pa kritere urbanistike, duke krijuar kështu zona informale. Të tilla janë zonat tek ish SMT-ja, ish NB Korça, tek rruga e Ersekës. Në këto zona bëhet i vështirë disiplinimi i ndërtimeve dhe krijohen vështirësi të mëdha në lidhje me infrastrukturën inxhinierike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, elektrik, telefon, etj).

Shkatërrimi i industrisë bëri që të ndryshojë koncepti për zonat industriale të mirëfillta. Një pjesë e ndërmarrjeve joefektive, që pushuan së prodhuari u përshtatën për degë të tjera të industrisë (për prodhime konfeksionesh, pijesh dhe punime artizanale) ose u kthyen në depo e magazina për zhvillimin e tregtisë. Duhet theksuar, se, në një masë mjaft të madhe një pjesë e objekteve industriale, u përshtat për banim, duke ndryshuar tërësisht funksionin e zonës industriale.

Ndërtimet e reja me karakter industrial si prodhime pijesh, përpunimi dhe prodhimi i produkteve ushqimore, punimet e drurit e të mermerit, në pjesën më të madhe janë zhvendosur në distancë nga qyteti, jashtë vijës së verdhë të tij, përgjatë rrugëve ndërurbane të rëndësishme, duke shfaqur tendencën e krijimit të zonave të reja industriale jashtë qytetit.

Ndërtimet brenda zonës ekzistuese të banimit kanë përmirësuar kushtet aktuale të banimit, duke shtuar rrezikun e shkatërrimit edhe të vlerave të kulturës e të arkitekturës.

Pjesa e kodrave që përfshihet brenda vijës së verdhë të qytetit dhe që përbën parkun periferik të qytetit, ishte mjaft e gjelbëruar, por në periudhën e tranzicionit u dëmtua nga prerjet e shumta. Për të rehabilituar gjelbërimin e kësaj zone nga Ndërmarrja e Shërbimeve Publike si dhe nga vetë qytetarët dhe biznesi, këto pesë vitet e fundit janë mbjellë mjaft pemë, duke i kthyer disi gjelbërimin kësaj zone, i dobësuar për shkak të dëmeve të mëdha të sjella nga këto shkatërrime. Pjesa e kodrave, që dikur ka qenë e gjelbëruar, sot në pjesën më të madhe i është kthyer ish-pronarëve dhe krijon vështirësi për gjelbërimin e tyre.

Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në qytet është një nga prioritetet e Bashkisë. Në këtë kuadër janë hartuar plane për ndërtimin e një parku të ri dhe synohen ndërhyrje në zona të reja banimi ku mungon gjelbërimi.

I.1 Rrjeti i kanalizimeve

Rajoni i qytetit të Korçës ka mjaft rezerva ujore, ai shquhet për ujëra nëntokësore të shumta. Vetë baseni ujor ka formën e një govate, me shtrirje nga jugu në veri, e kufizuar, në verilindje, me vargun e Malit të Thatë, në lindje me vargmalin Moravë – Mali i Kuq, në jug me vargmalin Qarr – Bellovodë – Dërsnik dhe në perëndim me vargmalin Voskop – Kolanec – Gorë.

Qyteti i Korçës furnizohet me ujë 24 orë në ditë nga puset e Turanit, përkatësisht nga puset 501, 502, 504, 505, me një kapacitet 280 litër/sek. Qyteti i Korçës furnizohet nëpërmjet një ujësjellësi të ri, të ndërtuar në parametra sanitarë bashkëkohorë. Ujësjellësi i qytetit të Korçës ka një klorinim të përditshëm dhe shumë të rregullt.

Sasia e ujit të faturuar ndaj atij të prodhuar aktualisht është 80%. Grumbullimi i të ardhurave gjatë vitit 2004 ka qenë në nivelin 96%.

Lagjet e vjetra të qytetit të Korçës si për shembull 1, 2, 3, 11 dhe 12 kanë një sistem kanalizimesh të ujërave të zeza të vjetër, i cili në disa zona është mbi 100-vjeçar. Kanalet janë me qemer dhe me plloça, sepse, në kohën kur janë ndërtuar këto sisteme, nuk ekzistonte teknologjia moderne. Dëmtimi i rrugëve dhe kalimi në to i mjeteve të tonazheve të rënda përbën rrezik për shkatërrimin e këtyre kanaleve.

Në lagjet e tjera të qytetit, që janë relativisht më të reja, ekzistojnë tubacione betoni për shkarkimin e ujërave të zeza. Por seksioni i këtyre tubacioneve është i vogël, sepse janë ndërtuar për një pallat, ndërkohë që, në sheshet përreth çdo pallati, janë ndërtuar dhe dy pallate të tjerë që përdorin të njëjtin tubacion për shkarkim. Prandaj tubacionet nuk kanë kapacitet për funksionim normal.

Migrimi i popullsisë pas viteve ’90 bëri që, në periferi të qytetit të Korçës, të krijohen zona të reja banimi pa sistem dhe, në më të shumtën e rasteve, pa kanalizime të ujërave të zeza. Kjo gjendje përbën shqetësim të madh në drejtim të mjedisit dhe të shëndetit.

Përveç ujësjellësit të qytetit, që është dhe furnizuesi kryesor i qytetit me ujë të pijshëm për banorët, nuk duhet injoruar dhe prania e “çezmave të dherit” që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm të furnizimit me ujë të pijshëm.

Rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza në qytetin e Korçës është përgjithësisht i amortizuar dhe me probleme tekniko-sanitare. Aktualisht, vazhdojnë të derdhen në mjedis të hapur 3 kanale të ujërave të zeza të qytetit:

1- në ish-zonën industriale të qytetit,
2- në afërsi të tregut të shumicës të fruta perimeve.
3- në unazë, poshtë urës së fajancës

Janë disa kanale kolektorë të derdhjeve të ujërave të zeza të qytetit, një pjesë e të cilave kalojnë në tokat bujqësore të ish-NB Korçë dhe shfrytëzohen për ujitje të perimeve nga pronarët e tokave. Të gjitha ujërat e zeza, pa asnjë lloj përpunimi, derdhen në lumin Dunavec duke shkaktuar ndotje të këtij të fundit. Një pjesë e banorëve që banojnë në afërsi të përroit të Drenicës, derdhin ujërat e zeza në këtë përrua, i cili vazhdon të ndotet vazhdimisht. Në qytetin e Korçës, shumica e banjave publike janë të parregullta nga ana tekniko-sanitare.

I.2 Mbetjet e ngurta

Qyteti i Korçës, gjatë vitit 2005, prodhon mesatarisht 74 ton mbetje të ngurta në ditë. Shtimi i konsumit të produkteve me një përdorim si shishe, kanoçe, bidonë plastikë, kartonë ambalazhi, etj., kanë rritur mjaft vëllimin e mbetjeve. Krahas mbetjeve urbane, ekzistojnë edhe mbetjet spitalore, të cilat arrijnë në vlerat 32 ton/vit, nga të cilat 2,5 ton/vit konsiderohen si mbetje të rrezikshme. Trajtimi i mbetjeve spitalore, për mungesë incineratori, është i njëjtë me atë të mbetjeve urbane.

Fusha e grumbullimit të mbetjeve të qytetit të Korçës (afër Fabrikës së tullave) nuk plotëson kushtet higjeno-sanitare. Mbetjeve të grumbulluara nuk u bëhet asnjë përpunim. Për shumë vite janë përdorur si vend depozitimi të mbetjeve gropat e ish-Fabrikës së tullës pasi shfrytëzoheshin për argjilë. Ekzistenca e fushës së grumbullimit të mbetjeve të ngurta në këtë vend është një mundësi për ndotjen e ujit të pijshëm të qytetit të Korçës dhe djegia e tyre, në jo pak raste, është shkaku i ndotjes së ajrit me gaze toksike, NOx, CO, dioksinë, etj.

Tabela 2 - Përbërësit e mbetjeve urbane në qytetin e Korçës

Nr.	Lloji elementëve përbërës në mbetjet urbane	Sasia në %
1	Mbetjet organike	37
2	Letra kartoni	11
3	Plastike	11
4	Tekstil	5
5	Qelqe	2
6	Metal	2
7	E kombinuar	2
8	Dru	0.7
9	Mb	29

I.3 Parqet, lulishtet, gjelbërimi i rrugëve

Parqet periferike

Parku periferik, në kodrat e qytetit, ka një sipërfaqe prej 12 ha. Kodrat e gjelbëruara kanë qenë një kurorë e bukur për qytetin dhe kanë patur një funksion jetik për popullsinë si mushkëri e qytetit dhe rregullues të mikroklimës. Gjatë periudhës së tranzicionit pati shumë probleme dhe dëmtime nga prerjet pa kriter, nga kullotja e bagëtive, nga sëmundjet dhe dëmtuesit, të cilat nuk u trajtuan në kohën dhe momentin e duhur.

Parqet ekzistuese

Korça ka një sipërfaqe të gjelbër prej 224.995 m^2, e përfaqësuar kjo nga parqe, lulishte, breza të gjelbër përgjatë rrugëve dhe drurë dekorativë në formë shëtitoreje. Qyteti i Korçës është një qytet me rrugë të gjelbëruara kryesisht me bli, gështenjë, panjë amerikane, mështekna, katalpa, frashër, etj.

Një fenomen që vihet re kohët e fundit është dëmtimi i bimësisë dekorative dhe sipërfaqet e barit në parqe dhe lulishte. Kjo si rezultat i dëmtimeve nga kalimtarët, makinat, bagëtia, plakja dhe degradimi i bimësisë ekzistuese. Ekzistojnë blloqe banimi ose lagje të reja të krijuara këto vitet e fundit, (si blloku në varrezat e qytetit), ku është krijuar dhe infrastruktura e rrugëve dhe trotuareve, e cila duhet plotësuar me bimësi dekorative.

Në mënyrë që gjelbërimi i qytetit të jetë i kompletuar, duhet që të përfaqësohet jo vetëm nga bimësia dekorative, por duhet të jetë i shoqëruar edhe me vepra arti, monumente kulture, shatërvanë, vazo dekorative, bordura, stola, pjergullata etj., dhe të gjitha këto përbëjnë ansamblin e plotë të një parku apo lulishteje. Por, vihet re një dukuri që si kudo është e pranishme edhe këtu: një dëmtim i madh i veprave të artit nga njerëz të papërgjegjshëm dhe keqdashës.

I.4 Cilësia e ajrit

Deri në vitin 1990, ndotja nga industria është konsideruar si burimi kryesor i ndotjes së ajrit atmosferik në qytetin e Korçës. Gjatë periudhës së tranzicionit dhe aktualisht sot vihet re një rënie e ndjeshme e veprimtarisë së industrisë. Në ato objekte ku aktualisht ka aktivitet industrial konstatohet se nuk përdoren më si lëndë energjetike qymyr guri, druri, të cilat janë zëvendësuar me lëndë të tjera energjetike si mazut, naftë, gaz metan dhe energji elektrike.

Gjatë viteve 1990 – 2003, konstatohet një rritje e ndjeshme e numrit të mjeteve të transportit rrugor të tonazheve të ndryshme, ku aktualisht numërohen (viti 2003) 8.689 mjete transporti në shkallë rrethi ose 62% e mjeteve që qarkullojnë në nivel prefekture. Automjetet në qarkullim janë prodhime të viteve 1980 – 1995 dhe pjesa më e madhe e tyre janë pa katalizatorë dhe shkaktojnë ndotje të mjedisit.

Infrastruktura rrugore e qytetit të Korçës paraqitet mjaft e dëmtuar. Lënia në gjendje jo të mirë, pas ndërhyrjeve për kanalizime, e rrugëve me kalldrëm karakteristik për qytetin e Korçës, ka rritur shkallën e ndotjes në qytet. Në shumë pjesë, rrugët janë të ndotura me baltë në kohë reshjesh dhe plot pluhur në mot të thatë, të cilat ndotin ajri duke shtuar nivelin e LGS (lëndë të grimcuara në suspension) dhe PM10 mbi normë.

Tabela 3 - Monitorimi i ajrit të qytetit të Korçës, krahasuar me qytetet e tjera (2004)

	LGS (P. total)	PM-10 Pluhur i respirueshëm	SO_2	NO_2	O_3	Pb
Norma (Shqip.)	140	60	60	60	120	1.0
OBSH	90	50	50	40	120	0.5
Tirana 1	286	119	16	37	95	0.13
Tirana 2	226	105	14	30	100	0.155
Tirana 3	126	70	13	20	91	0.12
Tirana 4	995	483	20	48	110	0.195
Tirana 5	215	98	10	20	110	0.25
Shkodra	224	99	9	14	85	0.22
Elbasani 1	266	117	19	25	96	0.21
Elbasani 2	416	203	43	73	-	0.3
Durrësi	200	92	12	17	96	0.28
Fieri	232	107	19	23	91	0.2
Vlora	144	63	10	16	92	0.19
Korça	147	67	8	12	87	0.066

Tabela 4 - Llojet e automjeteve në qytetin e Korçës

Nr.	Mjete transporti	Nr.	Përqindja %	Raporti mjet/banorë
1	Autovetura	5.264	60,58	1/38
2	Mikrobuza, autobuza	667	7,67	1/300
3	Kamionçina, kamion	2.111	24,29	1/94,8
4	Traktorë rrugorë	104	1,19	1/1.924
5	Motorçikleta, triçikla	281	3,29	1/712
6	Rimorkio	262	3,01	-

2.1 Treguesit e punës

a) Sektori shtetëror

Për vitin 2003, në rrethin e Korçës, zhvilluan aktivitetin ekonomik dhe institucional 96 ndërmarrje dhe institucione, prej të cilave 65 buxhetore dhe 31 jobuxhetore.

b) Sektori privat

Për vitin 2003, zhvilluan aktivitetin privat 3.109 ndërmarrje, të cilat 3.077 vendase dhe 32 firma të huaja, ku në qytet janë 2.371 ndërmarrje private ose 76,3% të totalit. Në krahasim me vitin 2002, ato kishin një rritje me 462 ndërmarrje ose 17%, ku rritje më të madhe pati në aktivitetin e ndërtimit me 61%, ndërmarrjet përpunuese 55%, hotele dhe restorante 22%. Nga ndërmarrjet private, 80,9% janë persona fizikë dhe 19,1 % janë persona juridikë.

c) Hotelet

Në qytetin e Korçës, ushtrojnë aktivitetin 13 hotele nga të cilat 5 turistikë me një kapacitet 200 dhoma me 376 shtretër. Gjatë vitit 2003 janë frekuentuar nga 12,026 persona shqiptarë dhe 486 të huaj.

d) Ndërtimi

Lejet e dhëna për ndërtim, gjatë vitit 2003, janë 269 objekte prej të cilave 231 janë banesa, 19 objekte tregtare, 10 objekte industriale, 9 objekte të infrastrukturës dhe të tjera. Vlera e të gjithë objekteve arrin shifrën 1.106 milion lekë. Për vitin 2003, vlera e objekteve të ndërtimit në krahasim me vitin 2002 është ulur në 323 milion lek, kjo si rezultat i uljes së numrit të objekteve për banesa dhe i vlerës së punimeve të ndërtimit. Nga ndërtimet 92% janë private dhe 8% janë shtetërore.

e) Shërbimi i transportit në qytetin e Korçës

Transporti në qytetin e Korçës është i organizuar sipas atij tradicional, me taksi, autobusë dhe furgonë. Këta janë të kontrolluar nga Bashkia e qytetit, e cila ka caktuar vendet dhe itineraret e tyre. Korça nuk ka lidhje me tren me qytetet e tjera të Shqipërisë dhe nuk ka as mundësi lundrimi të drejtpërdrejtë. Qyteti ka një mundësi strategjike, të planifikuar që kohë më parë, për ndërtimin e një piste avionësh për qëllime të ndryshme transporti.

Tabela 5 - Shërbimi i transportit në qytetin e Korçës

Lloji i transportit	Shtator 2003	Shtator 2004
Taksi	130	122
Transport mallrash për nevojat e veta	260	264
Transport ndërqytetës (autobusë në 13 linja)	20	25
Transport rreth qytetës (autobusë)	28	2

Tabela 6 - Aktiviteti ekonomik në qytetin e Korçës:

Lloji i aktivitetit	Nr. ndërmarrjeve	Pjesa në përqindje
Aktivitet ekonomik	27 ndërmarrje	28,1%
Aktivitet financiar	5	5,2
Aktivitet arsimor	3	3,1
Aktivitet shëndetësor	6	6,3
Aktivitete të tjera	50	52,1

III. Arsimi dhe edukimi mjedisor

Qyteti i Korçës njihet për traditat e tij arsimdashëse. Në Korçë është çelur shkolla e parë laike shqipe në Shqipëri dhe ky qytet ka qenë promotori i arsimit në vendin tonë.

Aktualisht qyteti i Korçës ka 14 kopshte, 13 shkolla 9-vjeçare publike dhe 1 private, 3 shkolla të mesme të përgjithshme publike, 2 shkolla të mesme të përgjithshme private dhe 6 shkolla të mesme publike të profilizuara (industriale, teknologjike, agrobiznes, ndërtim, gjuhë të huaja dhe muzikë). Në shkollat 9-vjeçare publike ka 366 mësues me 6.656 nxënës, kurse në shkollat e mesme ka 258 mësues me 4.083 nxënës.

Universiteti "Fan Noli", ka 4 fakultete: Ekonomik, i Bujqësisë, i Mësuesisë dhe i Infermierisë. Në të studiojnë rreth 2000 studentë, kryesisht të pjesës juglindore të Shqipërisë. (Të dhëna 2004)

Shkolla si qendër edukimi është bazë e edukimit qytetar dhe atij mjedisor të nxënësve. Në përgjithësi, në kuadër të edukimit qytetar, nxënësit marrin në shkollë dhe njohuri për edukimin mjedisor. Por edukimi mjedisor i marrë është i pamjaftueshëm për shumë arsye: mungesa e materialeve të shkruara, mungesa e një organizimi i aktiviteteve të përbashkëta, mangësitë në dhënien dhe marrjen e informacionit mjedisor, mungesa e qendrave të informimit mjedisor etj.

Në këtë kuadër, edhe në qytetin e Korçës, me gjithë përpjekjet e deritanishme, ka mangësi në organizimin e aktiviteteve për edukimin mjedisor. Disa shoqata mjedisore janë përpjekur të rrisin edukimin mjedisor të nxënësve, por mungesa e fondeve ka krijuar vështirësi për zhvillimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm të këtij procesi prej tyre.

Organizatat dhe institucionet që ofrojnë informim mjedisor në qytetin e Korçës janë:

- Këshilli i Qarkut Korçë, i cili, nëpërmjet projektit "Pastrim e Gjelbërim" ka hapur një qendër informimi për publikun, e cila jep informacion edhe për mjedisin. Në të ardhmen, kjo qendër, krahas informacionit mjedisor do të japë edhe informacion ekonomik, turistik etj.
- Shkollat 9-vjeçare të qytetit, të cilat, në përgjithësi, kanë ngritur këndin e edukimit mjedisor, ku pasqyrohen aktivitete mjedisore të kryera nga vetë shkolla.
- Shtëpia Kulturore e Fëmijëve "Mihal Grameno" punon për edukimin mjedisor të nxënësve të shkollave 9-vjeçare, duke organizuar aktivitete të ndryshme. Në këtë kuadër është ngritur Rrethi i Ambjentalistëve të rinj.
- Shoqatat mjedisore të qytetit dhe shoqatat e tjera, si ato të grave, etj.

Nga Korça për në rrethinat turistike

Voskopoja: një pikë turistike e rëndësishme, është perlë e peizazhit shqiptar. Ndodhet 20 km larg Korçës, midis Gorës dhe Oparit, në lartësinë 1.150 m mbi nivelin e detit.

Liqeni i Prespës së Madhe: është 25 km në veri të Korçës. Brigjet janë shkëmborë, të lartë dhe pjesërisht me rërë. Përfaqëson një nga perlat e rajonit.

Vithkuqi ndodhet mes malesh, pas fshatit Bellovodë. Vithkuqi është po aq i vjetër sa edhe Voskopoja. Në këtë pikë turistike, Manastiri i Shën Pjetrit përmban shumë piktura dhe ikona të famshme.

Boboshtica është e njohur jo vetëm për prodhimin e rakisë së manit, por edhe për kishat dhe manastiret, si Kisha e Shën Marisë, Shën Gjonit, si edhe një numër afreskesh mesjetare.

Mborja ndodhet vetëm 3 km nga Korça. Në këtë fshat gjendet një kishë e vjetër, Kisha e Ristozit, e ndërtuar në vitin 1390 mbi rrënojat e një kishe tjetër, e cila ka ekzistuar që nga shekulli i IV.

Vende turistike të tjera janë Parku Kombëtar i Bozdovecit, Mali i Moravës, Mali i Gorës, Ostrovica, Lenia, Rrungaja, Devolli, me shumë lloje të florës dhe të faunës. Të gjitha këto pika përmbajnë mundësi pushimi për familjarë dhe për të pasionuar të natyrës, pasi ofrojnë vlera të mëdha të florës dhe faunës. Kohët e fundit, këto pika kanë qenë në vëmendjen e biznesit për t'i kthyer ato në pika që ofrojnë turizëm të plotë dhe kurativ.

IV. Trashëgimia kulturore

Gjetjet arkeologjike kanë mbështetur përfundimin që Korça është një nga vatrat kryesore të qytetërimit prehistorik në Ballkan. Vlerat e jashtëzakonshme turistike dhe kulturore të këtij qyteti janë të gërshetuara dhe të lidhura ngushtë me ato natyrore. Në të gjithë territorin e qytetit dhe jashtë tij ekzistojnë vende shumë të rëndësishme historiko-kulturore të vendosura në pika të rëndësishme natyrore.

Menaxhimi i drejtë i këtyre vlerave dhe përgatitja e guidave dhe e informacioneve, të cilat nxjerrin në pah këto elemente, do të shërbejnë si pikë e fortë për afrimin e më shumë turistëve në këtë qytet, gjë e cila do t'i jepte më shumë shanse dhe vëmendje zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes, përmirësimit dhe garantimit të një mjedisi urban dhe natyror të qëndrueshëm.

Në qytet dhe rrethinat e tij ekziston një rrjet atraksionesh kulturore të rëndësishme:

1. Xhamia e Iljaz Minahorit. Është monumenti më i vjetër i qytetit i vitit 1496, ka vlera historike, kulturore e fetare, por dhe arkitektonike. Xhamia e Minahorit është xhamia e parë me kube e ndërtuar në Shqipëri.
2. Shkolla e parë shqipe. Është muzeu që tregon historinë dhe vlerat e arsimit shqip, i hapur në 7 mars 1887, pasurohet herë pas here me dokumentacionin e nevojshëm, duke treguar historinë e zhvillimit arsimor të popullit shqiptar.
3. Muzeu i Artit Mesjetar. Është unik në llojin e tij në vendin tonë. Ai është qendër e rëndësishme e ruajtjes, e restaurimit dhe e popullarizimit të artit mesjetar. Përmban 7,000 objekte arti me vlera historike, kulturore, artistike, si piktura kulti, kryesisht ikona e më pak punime druri, guri e metali. Në të gjenden ikonat më të mira, të krijuara nga piktorë të shek. 12 e në vazhdim.
4. Muzeu Arkeologjik. Është i vendosur në një shtëpi karakteristike të ndërtuar në shek. 19, me vlera të çmuara arkitektonike. Muzeu jep pasurinë arkeologjike të trevës juglindore të Shqipërisë. Gjetjet nga gërmimet në këtë zonë dëshmojnë për zhvillimin e saj nga mijëvjeçari i gjashtë para erës sonë deri në shek. 4t si dhe objekte nga periudha helenike, romane e paleobizantine.
5. Shtëpia muze e piktorit Vangjush Mio është një shtëpi karakteristike, pronë e piktorit që dëshmon për vlerat e këtij piktori si një pejsazhist i rrallë.
6. Pallati i Kulturës. Është ndërtesë e viteve '30. Ajo ka shërbyer si ndërtesë e artit dhe kulturës korçare, qendër e grupit karakteristik të Korçës "Lira" si dhe qendër e grupit profesionist "Serenata Korçare".
7. Biblioteka "Thimi Mitko". Ky objekt është pjesë e sistemit kulturor të qytetit të Korçës. Ka vlera unikale jo vetëm ndërtimore, por edhe kulturore, historike, artistike të qytetit.
8. Pjesa tjetër e qytetit, e përfaqësuar me lagjet 1, 2, 3, 11, 12, e quajtur ndryshe lagjet karakteristike korçare, me shtëpi me kangjella e dritare karakteristike, i japin qytetit specifikën e tij.
9. Objekte kulturore.
   - Monumenti i Luftëtarit Kombëtar – i realizuar me mjeshtëri nga skulptori Odise Paskali, i vendosur në sheshin e qytetit, është simbol i këtij qyteti.
   - Monumenti i Themistokli Gërmenjit – sintetizon luftën e Korçës për autonomi. Shtëpia e këtij patrioti është transformuar në shtëpi muze dhe tani ajo është Bar-Restorant "Vila Themistokli", ku shihet ndërthurja e biznesit me historinë.
10. Kishat dhe xhamitë

    Ndër kishat dhe xhamitë më kryesore përmendim:
    - Kisha e Mitropolisë - ndodhet në qendrën e Korçës së vjetër, me një histori të lashtë që prej shek.16-17. Shumë prej ikonave u përkasin viteve 1693-1727.
    - Katedralja - e vendosur në qendër të qytetit, është nga më të mëdhatë në Ballkan.
    - Kisha e Shën Thanasit - datohet në shek. 17-18. Vendndodhja në kodër ia shton vlerat këtij

objekti, duke e bërë ndër kishat më të frekuentuara të qytetit.
- Kisha e Shën Ilias - tashmë e restauruar, ndodhet në pjesën verilindore të qytetit mbi një kodër të bukur.
- Xhamia e Re – e ndërtuar për besimtarët myslimanë shërben si objekt fetar për ritet e caktuara.

11. Pazari i Korçës – është objekt me vlera të hershme historike, kulturore e artistike. Karakterizohet nga ndërtesa në përgjithësi 1 e 2 katëshe, rrugica të ngushta e një stil ndërtimi që tërheq vëmendjen e vizitorëve. Ai ka qenë i shquar për hanet e vendosur njëri pas tjetrit. Tregu, me rreth 1.000, dyqane arriti kulmin e tij gjatë fundit të shek. 19 dhe fillim të shek. 20. Në strukturën urbanistike të qytetit, pazari krijonte një ansambël më vete. Të dy pjesët e pazarit, që ndaheshin nga lumi, lidheshin me ura të drunjta, ndërsa rruga kryesore që vinte nga qyteti, e kalonte lumin mbi një urë të gurtë me qemerë, sipër së cilës ngriheshin dyqane.

Korça ka vlera të veçanta kulturore, por edhe dëmtime që fshijnë një pjesë të kësaj kulture. Kështu, ka ekzistuar Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare, por tani nuk dihet se ku një vizitor mund të marrë informacion për të.

Gjithashtu, është për të ardhur keq që në Korçë nuk gjen qendra apo njësi tregtimi të zejeve tradicionale.

Sidoqoftë, turizmi kulturor ka premisa për t'u zhvilluar sepse, Korça, së bashku me fshatrat përreth ka atraksione të fuqishme kulturore ku futen objekte muzeale, fetare që kanë vlera jo vetëm në vendin tonë, por edhe për rajonin e Ballkanit.

Por turizmi kulturor ka edhe probleme:
1. Mungesa e informacionit për oraret e hapjes së muzeumeve.
2. Muzeu i Luftës Nacionalçlirimtare, i cili ka ekzistuar në qendër të qytetit, tani është plotësisht i shkatërruar. Madje dhe objektet e këtij muzeu nuk dihet ku ndodhen.
3. Mungesa e publikimeve promocionale me informacione për atraksionet kulturore të qytetit. Ekzistenca e një informacioni të tillë do të bënte të mundur që turistët të njiheshin me vlerat kulturore të qytetit për t'u vizituar.

Disa nga mundësitë që ka Korça të zhvillojë turizmin kulturor, janë:
- Së pari, ekzistojnë atraksionet kulturore në qytet, që po të bashkohen edhe me atraksionet kulturore të fshatrave, do të ishin si një perlë vezulluese.
- Së dyti, ekzistojnë njësitë akomoduese, të përfaqësuara nga hotelet si edhe shtëpi të lëshuara me qera për turistët, por niveli i shërbimit duhet të përmirësohet ndjeshëm.
- Së treti, ekziston një jetë e pasur kulturore në Korçë, me tradita të veçanta dhe ngjarje speciale, që kanë nevojë të promovohen me profesionalizëm dhe jo t'i lihen rastësisë.

Në hartimin e politikave për të gjallëruar turizmin kulturor, duhet të mbahet parasysh fakti që shumë prej turistëve kanë me nivel arsimor të lartë dhe që janë gati të shpenzojnë shumë para. Në këto kushte shërbimi dhe niveli turistik duhet të jetë në nivele maksimale.

Analiza

Problemeve

Urbanistika					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Krijimi i zonave me ndërtime të jashtëligjshme (zona informale)	Lëvizja e lirë e pakontrolluar dhe pamundësia e pushtetit vendor për kontrollin e ndërtimeve	E konsiderueshme në lidhje me rritjen e numrit të ndërtimeve të jashtëligjshme	Popullsia e zonës informale dhe popullsia e zonës përreth. Kryesisht zona suburbane e qytetit	Rritja e sasisë së pluhurit në atmosferë. Rreziku i përhapjes së epidemive nga mungesa e kanalizimeve Planifikim i papërshtashëm i territorit duke ndikuar negativisht mbi tokën, dhe jetën e qytetarëve, duke sjellë mungesën e lulishteve, rrjeteve të mirëfillta të kanalizimeve, etj	*
Rritja e trafikut në qytet Mospërballimi i trafikut nga rrjeti rrugor. Mungesa e vendparkimeve.	Rritja e numrit të automjeteve	E mesme Në rritje	Gjithë qyteti, sidomos popullsia e lagjeve të zonës historike.	Rritje e ngarkesës në ajër; Rritje e zhurmave në mjedis; Dëmtim i zonave me rëndësi historike dhe turistike; Rritja e numrit të aksidenteve.	* * *
Dalja e zonës industriale jashtë funksionimit. Disa fabrika dhe ndërtime të tjera industriale, janë lënë në mëshirë të fatit, duke u kthyer në burim shumë të madh ndotës si për tokë, ajrin dhe për ujërat nëntokësore, si kanë prishur imazhin e një qyteti mikpritës	Ndryshimi i sistemit Mungesa e privatizimeve dhe e investimeve madhore në industri	E lartë	Gjithë qyteti	Shtimi i sasisë së mbetjeve, ulja e nivelit të jetesës.	* *

Përshtatja për banim. Mungesa e një plani rregullues për qytetin i ka lënë dorë të lirë ndërtimeve pa kriter.	Rritja e nevojës për banim Mosrespektim i ligjeve në fuqi	E mesme	Pothuajse i gjithë qyteti, pasi këto ndërtime ndikojnë në sistemet e qytetit dhe në mundësinë përballuese të tij	Rreziku nga ndotja, sidomos në ish-objektet e industrisë së rëndë. Dëmtim për një periudhë të gjatë i vendeve ku bëhet ndërhyrja	* *
Industria artizanale. Ngritja e disa industrive artizanale, ka sjellë në qytet problemin e shkarkimeve në ajër dhe zhurmave në mjedis.	Nevojat për vetëpunësim. Ndërtimi jashtë kushteve higjieno-teknike Mos respektim i ligjit për VNM	E ulët	Banorët rreth këtyre ndërmarrjeve 30% e banorëve	Nivel i lartë i ndotjes së mjedisit përreth; Rrezik sëmundjesh për stafin që punon në këto ndërmarrje, si rezultat i mosrespektimit të kushteve higjieno-sanitare në mjediset e brendshme; Aksidente në punë.	*
Sistemi elektrik i amortizuar. Si rezultat i rritjes së kërkesës për energji elektrike, janë bërë ndërhyrje të pakontrolluara në sistem, duke u bërë shkak për rritjen e rreziqeve nga energjia. Duke qenë se sistemi ekzistues nuk parashikonte rritjen e kërkesës për energji, nuk është në gjendje ta përballojë atë.	Koha e ndërtimit, zgjerimi i qytetit.	E lartë	Gjithë qyteti.	Rreziku i rënies së zjarrit Dëmtim i shëndetit si rezultat i jonizimit të ajrit.	* * *

Urbanistika (uji, kanalizimet dhe mbetjet urbane)					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Uji					
Ndotja e basenit ujor Qyteti i Korçës furnizohet me ujë nga zona përreth qytetit. Në këto zona janë kryer ndërhyrje pa marrë në konsideratë kushtet higjieno-sanitare dhe teknikën mjedisore të tyre. Në fshatin Turan, nga ku qyteti merr ujin, shkarkohen plehrat e qytetit të Korçës dhe zona ndotet në shkallë të lartë nga gropat septike dhe mbetjet organike të fshatrave përreth.	Ndërtime pa leje dhe shkarkime në zonën ujëmbajtëse. Fusha e plehrave mbi basen.	E lartë Depërtimi është i ngadalshëm, por po u ndot uji nuk pastrohet më.	Gjithë qyteti.	Probleme shëndetësore dhe epidemi nga uji i ndotur.	* * *
Kanalizimet e ujërave të zeza					
Kanale të vjetra Sistemi i kanalizimeve është shumë i amortizuar dhe nuk është në gjendje të përballojë tendencat e reja të zhvillimit të qytetit.	Dëmtimi i kanaleve për shkak të ndërhyrjeve në të; Amortizimi i sistemit për shkak të moshës së tij;	E mesme	50 % e qytetit	Rrezik epidemish nga dalja në sipërfaqe e ujërave të përdorura.	* * *
Kapacitet i ulët i tubacioneve relativisht të reja.	Shtimi i ndërtesave dhe i popullsisë.	Në ngritje.	Gjithë qyteti	Aromat që dalin nga pusetat janë helmuese për kalimtarët.	* *

Mungesë kanalizimesh në zonat e reja të banimit. Zhvillimi i qytetit në drejtime të ndryshme dhe pa një plan rregullues të miratuar së fundmi, ka sjellë për pasojë urbanizimin jokorrekt të zonave, duke ndikuar drejtpërdrejt në sistemet që i shoqërojnë ato.	Mungesë studimesh bashkëkohore; Mos respektim i rregullave dhe ligjeve	E lartë	Lagjet e reja të qytetit Rreth 30%	Të gjitha problemet që lindin nga mungesa e planifikimit mjedisor dhe higjieno-sanitar, si mungesë zonash të gjelbëruara, ajër i ndotur, rrezik epidemish, etj	* * *
Mbetjet e ngurta					
Fusha e grumbullimit të mbetjeve jashtë kontrollit Qyteti i Korçës shkarkon mbetjet e tij në fushën e cila ndodhet në dalje të qytetit për në Voskopojë. Kjo fushë është tashmë totalisht jashtë kontrollit dhe një rrezik i madh sëmundjesh për të gjithë zonën.	Fusha është ndërtuar pa marrë në konsideratë kushtet higjieno-sanitare; Koha e gjate e shfrytëzimit të saj; Mungesë menaxhimi i mbetjeve që gjenden në të.	Shume e lartë	Gjithë qyteti	Helmime nga gazrat që era i sjell mbi qytet; Shkatërrim i tokës në të cilën gjendet fusha; Rritje e rrezikut të ndotjes së ujërave nëntokësore.	* * *
Mospastrimi i zonave të reja të banuara. Disa zona të qytetit nuk janë përfshirë në kontratën e pastrimit dhe në këto kushte situata e pastrimit të mbetjeve mbetet shumë e rëndë.	Mospërfshirja në kontratë	E lartë	Lagje të reja Rreth 30% e qytetit	Rritje e rrezikut të popullatës, për shkak të rreziqeve epidemike. Krijimi i një mjedisi jo të përshtatshëm nga ana figurative dhe jetës.	* *
Mospastrimi i rrugëve dhe shesheve në borë e akull.	Mungesa e mjeteve teknologjike	Problematike	Gjithë qyteti	Rrëzime dhe fraktura	*

Zonat e gjelbra					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Mungesa e infrastrukturës në parqet periferike	Janë dëmtuar nga prerjet pa kriter, nga dëmtimet e kullotjes së bagëtive	E mesme	E gjithë popullsia e qytetit	Mungesa e mjediseve çlodhëse dhe për pasojë ajër më i ndotur; mjedis jo i përshtatshëm; mungesa e mjediseve për rigjenerim; ulen vlerat turistike dhe tërheqëse të qytetit	* *
Mungesa e infrastrukturës në parqet ekzistuese	Dëmtimet vijnë si rezultat i keqtrajtimeve nga kalimtarët, bagëtia dhe plakja e degradimi i bimësisë ekzistuese	E lartë	E gjithë popullsia e qytetit	Mungesa e mjediseve çlodhëse dhe për pasojë ajër më i ndotur; mjedis jo i përshtatshëm; mungesa e mjediseve për rigjenerim; ulen vlerat turistike dhe tërheqëse të qytetit	* *
Boshllëqe të bimësisë me drurë dekorativë në rrugët ekzistuese dhe mungesat në mbjellje në rrugët e reja.	Diferencat e bimësisë në drurët dhe shkurret e rrugëve vijnë si rezultat i dëmtimit nga kalimtarët dhe moszënia e bimësisë dhe tharjet.	E mesme	E gjithë popullsia e qytetit	Mungesa e mjediseve çlodhëse dhe për pasojë ajër më i ndotur; mjedis jo i përshtatshëm; mungesa e mjediseve për rigjenerim; ulen vlerat turistike dhe tërheqëse të qytetit	* * *

Mungesa e parqeve dhe lulishteve në bllok-pallatet ekzistuese dhe në ato që do të ngrihen të rinj	Mungesë fondesh	E lartë	E gjithë popullsia e qytetit	Mungesa e mjediseve çlodhëse dhe për pasojë ajër më i ndotur; mjedis jo i përshtatshëm; mungesa e mjediseve për rigjenerim; ulen vlerat turistike dhe tërheqëse të qytetit	* *
Dëmtimi i veprave të artit. Dëmtime në monumentet e kulturës, bordura rrugësh, stola, shatërvanë, etj.	Dëmtimi vjen si rezultat i dëmtimeve nga kultura e ulët e kalimtarëve; - Koha e gjatë e mosvënies dorë për rregullim dhe mirëmbajtje, etj.	E lartë	E gjithë popullsia e qytetit	Ulen vlerat turistike të qytetit; ulet interesi i turistëve	*

Ajri dhe Shëndeti					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Ndotja e mjedisit, tokës dhe rreziku për ndotjen e ujërave nëntokësore në zonën e vendburimeve të ujit të pijshëm të qytetit të Korçës, fshati Turan.	Prej disa vjetësh në territorin në afërsi të burimeve të ujit të pijshëm të Turanit, ku furnizohet qyteti i Korçës, zhvillohet tregtimi i bagëtive të gjalla për rrethin e Korçës, duke shkaktuar ndotje të tokës dhe rrezik për ndotje në perspektivë të ujërave nëntokësore.	E lartë Depozitimi i produkteve të jashtëqitjes të kafshëve prej disa vjetësh në territorin ekzistues të tregut të kafshëve të gjalla, ka sjellë ndotje të tokës me amoniak, nitrite, klorure, parazitë të kafshëve, mikroorganizma patogjenë, brucela, tenja, ekinokok, etj.	Popullsia e qytetit Korçë dhe e fshatit Turan.	Sëmundje gastro-intestinale, enterite, salmonela, shigela, hepatit viral, antropozonoza, elmintoza, etj	* * *
Ndotje e tokës dhe e ujërave sipërfaqësore, rrezik për ndotje e ujërave nëntokësore si pasojë e dëmtimit të kanalizimeve të ujërave të përdorura të qytetit apo derdhjeve të tyre në ujërat e përroit të Drenicës, Barçit dhe lumit të Dunavecit, të patrajtuara paraprakisht.	Të projektuara dhe ndërtuara shumë vjet përpara, kanalizimet kryesore (me qemer dhe gurë të thatë ose me tub betoni), në shumë raste janë të dëmtuara. Nga statistikat që kemi rezulton se në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të përdorura ndodhin çdo vit rreth 900 defekte. Ka disa zona si: fusha e druve, pranë varreve të francezëve, ish-zona industriale e qytetit në rrugën Korçë-Tiranë që pothuajse nuk kanë kanalizime. Blloku i banesave që janë ngritur përgjatë përroit të Barçit derdhin ujërat e përdorura në këto përrenj duke shkaktuar ndotjen e tyre pasi edhe prurjet e tyre shumë vjeçare rezultojnë të ulëta.	E mesme	Pjesa më e madhe e qytetit të Korçës, e cila furnizohet me ujë të pijshëm pikërisht nga burimet nëntokësore, përreth qytetit.	Sëmundje të karakterit parazitar, sidomos tek fëmijët, çrregullime gastro-intestinale, dizenteri, salmonelozë, por edhe sëmundje të lëkurës.	* * *

Ujitja e perimeve me ujërat e përdorura të qytetit Korçë.	Grykëderdhjet e ujërave të përdorura të qytetit të Korçës, më kryesoret janë të shtrira në rrugën e Voskopit, ajo e Tiranës dhe tjetra për në ish-fushën e Stefanecit. Këto ujëra të përdorura shfrytëzohen nga përdoruesit e tokave për të vaditur perimet e tyre. Këto ujëra kanë përmbajtje të lartë mikrobiale si salmonelë, Escherichia coli, streptokok, shigeloza, hepatit viral dhe helminte. Gjithashtu këto janë të përziera me ujërat teknologjike me përmbajtje sode kaustike, kromate, etj.	E.Lartë Produktet që ujiten me këto ujëra kontaminohen me mikrobet e sipërpërmendura si dhe me mbetjet kimike të ujërave teknologjike.	Popullsia që konsumon këto produkte bujqësore, qytetit Korçë dhe konsumatorët e rretheve të tjera.	Shkaktohen sëmundje të tilla si dizenteri, salmonelozë, hepatit viral, helmintozë dhe kanë prirje për shfaqjen e sëmundjeve malinje.	* * *
Ekzistenca e fushës së grumbullimit të mbetjeve urbane në zonën afër qytetit të Korçës mbi pellgun ujëmbajtës.	Fusha e grumbullimit të mbetjeve urbane e vendosur në afërsi të fshatit Ravonik, Korçë, nuk bën asnjë lloj përpunimi të mbetjeve urbane, por shfrytëzohen gropat e ish-fabrikës së tullave duke i mbushur ato. Heqja e shtresës argjilore që shërben si izolues dhe mbrojtëse e ujërave nëntokësore e bën me problematike ekzistencën e kësaj fushe në këtë vend. Në shumë raste, djegiet e provokuara të plehrave krijojnë një tym të rrezikshëm për banorët e qytetit të Korçës dhe atyre të fshatit Ravonik dhe Qatrom. Një tufë e madhe derrash përdorin si ushqim mbetjet urbane duke krijuar kështu dyshime për sigurinë e mishit që konsumohet nga therja e tyre. Në këtë vend grumbullohen dhe mbetjet spitalore, të cilat vlerësohen si tepër të rrezikshme.	E.Lartë Ndotja e ujërave nëntokësore me mikroorganizma patogjenë dhe kimikate. Ndotja e ajrit me gaze të tillë si indol, fenol, skatol, dioksinë bëhet nga fermentimi dhe djegia e tyre në mjedis të hapur. Gjithashtu ka kontaminim të mishit të derrave që ushqehen në këtë zonë. Zhvillimi i insekteve sëmundje shkaktuese.	E gjithë popullsia e qytetit që konsumon ujë, zona e banuar afër zonës së grumbullimit, banorët e lagjes 8, 18 Korçë, fshati Ravonik, Qatrom kanë ndikime të erës së keqe.	Ndikime në organet e të parit (sy), konjunktivite, në organet e sipërme të frymëmarrjes, bronkite, bronkite azmatike, antropozonoza nga konsumimi i mishit të pasigurt (mishi i derrave).	* * *

Ndotja e ajrit të qytetit të Korçës nga pluhurat e rrugëve, kryesisht nga lëndët e grimcuara në suspension (LGS) dhe PM10.	Studimi i cilësisë së ajrit të qytetit të Korçës, realizuar nëpërmjet monitorimit të tij gjatë gjithë vitit nga Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Parësor Korçë në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik Tiranë, tregojnë shifra më të larta se rekomandimet e OBSH për LGS dhe PM10. Këto lëndë ndotëse kanë në përbërje të tyre pluhurin e ashpër të rrugëve si dhe shkarkimet e automjeteve në ajër.	E lartë Niveli i pranisë së LGS, mbi nivelet e rekomanduara nga OBSH, vjen nga pluhuri i rrugëve, aktivitete ndërtimore dhe për faktin që Korça ka shumë rrugë të paasfaltuara. Rrugët ekzistuese me gurë dhe kalldrëme nuk realizojnë dot fshirje dhe larje nga subjektet administruese të pastrimit të qytetit. Lënia për një kohë të gjatë të rrugëve të Korçës të dëmtuara dhe me gropa ka ndikimin e vet në rritjen e LGS.	Pjesa e popullsisë e përqendruar në rrugët e dëmtuara, duke mos përjashtuar dhe pjesën tjetër të qytetit.	Dëmtimet në shëndet janë kryesisht në rrugët e sipërme të frymëmarrjes, rinit, faringit, organet e të parit (sy). PM10 depërton edhe në indin mushkëror dhe sjell dëmtim të indit alveolar duke çuar në të grimcat e plumbit, kadmiumit dhe HAP (hidrokarbure aromatike policiklike) me pasoja bronkopati kronike.	* * *
Tregtimi i produkteve blegtorale si djathë, gjizë, vezë në kushte jo te mira higjieno-sanitare.	Krahas ekzistencës te tregtimit të produkteve blegtorale në supermarkete në kushte të mira frigoriferike, ekziston dhe tregu fshatar i këtyre produkteve. Fshatarët i ekspozojnë produktet e tyre mbi disa banakë çimentoje me sipërfaqe të dëmtuara, jo lehtësisht të pastrueshme dhe ruajtjen e produktit mbas mbylljes së tregut e realizojnë në disa dollapë të modifikuara poshtë banakëve të tyre në mjedise të pa përshtatshme; mungojnë banakët frigoriferikë. Në këtë treg jashtë kushteve frigoriferike, nën ndikimin e faktorëve mjedisorë si dielli gjatë ditës ruhen dhe tregtohen vezët.	E lartë Origjina e prodhimit të një pjese të konsiderueshme të produkteve të këtij tregu fshatar prodhohen në kushte shtëpiake, jashtë kushteve higjienike, nga persona me informacion të pakët shëndetësor. Ruajtja dhe tregtimi i këtyre produkteve në kushte të pa përshtatshme higjienike në treg komprometon sigurinë ushqimore dhe dëmton konsumatorin	Një pjesë e konsiderueshme e konsumatorit korçar që ende i drejtohet tregut fshatar.	Çrregullime gastrointestinale, helmime ushqimore, salmonelozë, zoonoza, kryesisht bruceloza që është e pranishme në shifra të larta në rrethin dhe qytetin e Korçës.	* * *

Edukimi					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Infrastruktura shkollore					
Mungesa e materialeve të shkruara për edukimin mjedisor	Mungesa e fondeve dhe mungesa e një angazhimi institucional për gjetjen e mundësive	Lartë	Mësuesit, Nxënësit	Mungesë informimi i brezit të ri mbi mundësitë për rritjen e tyre në mënyrë të kulturuar, duke privuar brezat e ardhshëm nga një kulturë qytetare që respekton mjedisin dhe mbron shëndetin	* *
Mangësi në formimin e mirëfilltë mjedisor të stafit mësimdhënës Në shkolla mungojnë mësuesit me formim të mirëfilltë mjedisor. Megjithatë mësuesit e lëndëve natyrore konsiderohen si përgjegjësit kryesorë për shpërndarjen e këtij edukimi	Staf i kufizuar Mungesa e trajnimeve konkrete për mësuesit e lëndëve natyrore	Lartë	Nxënësit	Rritja e një brezi të ri me kulturën e pamjaftueshme mjedisore dhe qytetare, duke çuar për pasojë në krijimin e problemeve në dëm të mjedisit.	* * *
Mungesa e programeve mjedisore Në shkolla mungon literatura bashkëkohore mjedisore si dhe orët praktike në mjedis	Mungesa e organizimit	Mesme	Mësuesit, Nxënësit	Rritja e një brezi të ri me kulturën e pamjaftueshme mjedisore dhe qytetare, duke çuar për pasojë në krijimin e problemeve në dëm të mjedisit	* *

Qendrat e informimit publik					
Mungesa e mjeteve të informimit të publikut për sa i përket çështjeve mjedisore Megjithëse Korça është qytet shembullor për vëmendjen që media i kushton çështjeve të zhvillimit dhe atyre mjedisore, përsëri kërkohet që aktorë të ndryshëm të realizojnë pjesëmarrje më të lartë	Mungesa e kapaciteteve të mirëfillta Mungesa e fondeve	Lartë	I gjithë qyteti	Ul mundësitë për zhvillimin e turizmit Përjashton komunitetin nga vendimmarrja, duke rrezikuar bashkëpunimin e tij në projektet që janë në përmirësim dhe mbrojtje të mjedisit	* * *
Numri i vogël i qendrave të informimit publik Megjithëse në qytetin e Korçës është ngritur një qendër informimi për publikun lind nevoja për ngritjen e një të tille pranë Bashkisë Korçë dhe në qendra, të cilat arrihen lehtë nga publiku, si sheshe apo bulevarde që frekuentohen rregullisht	Mungesa e një angazhimi serioz nga aktorët vendorë Mungesa e fondeve	Mesatare	I gjithë qyteti	Ul mundësitë për zhvillimin e turizmit Përjashton komunitetin nga vendimmarrja duke rrezikuar bashkëpunimin e tij në projektet që janë në përmirësim dhe mbrojtje të mjedisit	* *
Roli i OJF-ve					
Numri i pakët i OJF-ve Në qytetin e Korçës veprojnë aktivisht 2-3 shoqata vendore. Disa prej shoqatave të krijuara më herët, tashmë nuk ndërmarrin më aktivitete të mirëfillta dhe numri i tyre mbetet akoma shumë i vogël për të arritur rezultate konkrete.	Mungesa e kapaciteteve, kryesisht në sigurimin e fondeve	Lartë	I gjithë qyteti	Mundësi të pakta ndërgjegjësuese për publikun Numër i pakët projektesh në ndihmë të mjedisit dhe edukimit në komunitet Mungesa e një oponence dhe force lobuese në mbrojtje të çështjeve të mjedisit	* * *

Trashëgimia kulturore, mundësitë e zhvillimit të turizmit në qytet					
Problemi	**Shkaku**	**Shkalla e ndikimit**	**Popullsia që preket**	**Pasojat**	**Prioritarizmi**
Objekte historike të pambrojtura e të pa menaxhuara. Muzeu i Luftës me objektet e tij nuk mund të vizitohet. Muzeume që nuk funksionojnë sipas grafikëve, orareve dhe mungesa në to e ciceronëve profesionalë. Mungesa e një guide turistike profesionale për qytetin e Korçës.	Klauzolat e mbi pronën, lënia pas dore e cilësisë së menaxhimit të objekteve dhe institucioneve kulturore.	E lartë	Banorët e qytetit të Korçës dhe vizitorët.	Ulje e vlerave turistike të qytetit	* * *
Mungesa e paketave turistike profesionale. Agjencitë që funksionojnë nuk hartojnë paketa turistike profesionale për tërheqjen e klientelës së huaj dhe vendase.	Mosrakordimi midis turistëve, hoteleve dhe agjencive si një mundësi shtesë për rritjen e numrit të turistëve. Mungesa e një promovimi profesional i produktit turistik kulturor i gërshetuar me aktivitet argëtuese.	E lartë	Vizitorët, turistët, por edhe banorët e qytetit tek të cilët vjen një numër më i vogël turistësh.	Ulje e vlerave turistike të qytetit. Mundësitë e pakta për turistët të interesuar për vendin	* *
Menaxhimi jo profesional i hoteleve, mungesa e restoranteve tradicionale.	Staf me një nivel të ulët profesional dhe standardet e cilësisë jo bashkëkohore. Nuk promovohen profesionalisht restorantet tradicionale.	E mesme	Turistët, banorët e qytetit, personeli i njësive turistike.	Ulje e vlerave turistike të qytetit	* *

Plani

Veprimit

Urbanistika					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati Kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosotoja (lek)**	**Efekti**
Krijimi i zonave të jashtëligjshme (zona informale)	Dalja e ligjit të legalizimit të zonave informale dhe hartimi i studimeve urbanistike.	* * * Afatshkurtër	Njësia e Legalizimit DPUT-së pranë Bashkisë Korçë.	E pallogaritur	Përmirësimi i jetesës në këto zona me anën e ngritjes së infrastrukturës dhe pakësimi në minimum i ndërtimeve të jashtëligjshme.
Mospërballimi i trafikut nga rrjeti rrugor. Mungesa e vendparkimeve.	Hartimi i studimeve për rikonstruksionin e rrjetit rrugor dhe realizimi i tyre.	* * * Afatmesëm	Bashkia Korçë	10.000.000	Përmirësimi i qarkullimit të mjeteve dhe këmbësorëve. Mbrojtja e zonave të veçanta të qytetit nga mbitrafiku
Nxjerrja e zonës industriale jashtë funksionimit. Përshtatja për banim.	Studimet për tjetërsimin e këtyre zonave dhe krijimi i zonave të reja industriale jashtë qytetit.	* * * Afatmesëm	Bashkia Korçë, Biznesi	1.000.000	Krijimi i mundësive për zona të reja banimi dhe përmirësimi i kushteve mjedisore.
Sistemi elektrik i amortizuar dhe ndriçimi i qytetit.	Rikonstruksioni i përgjithshëm i rrjetit elektrik të qytetit Korçë.	Fillim 2005 deri 2 vjet	KESH	7.000.000.000	Përmirësimi i rrjetit elektrik dhe zgjidhja një herë e përgjithmonë e këtij problemi. Mbrojtja e qytetarëve nga rreziku që shfaqet nga sistemi i amortizuar.

Mungesa e studimeve të plota urbanistike për zona e blloqe banimi.	Fillimi i hartimit të këtyre studimeve.	Në vazhdimësi për çdo vit.	Bashkia Korçë	700.000	Kryerjen e ndërtimeve sipas parametrave bashkëkohore (dendësia e ndërtimit, cilësia e ndërtimit, dendësia e popullsisë, etj).
Industria artizanale e pakontrolluar	Hartimi i studimeve për përmirësimin e kushteve të kësaj industrie.	Në vazhdimësi çdo vit.	Bashkia Korçë, Biznesi i vogël artizanal	400.000	Harmonizimi i këtij aktiviteti me qendrat e banimit.

Urbanistika – uji, kanalizimet dhe mbetjet urbane					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati Kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosotoja (lek)**	**Efekti**
Uji, kanalizimet e ujërave të përdorura: Ndotja e basenit ujor; Kanale të vjetra; Kapacitet i ulët i tubacioneve relativisht të reja; Mungesë kanalizimesh në zonat e reja të banimit; Dekantimi i ujërave teknologjike tek ish-NB, të cilat janë mjaft të rrezikshme.	Vazhdimi i ujësjellësit të qytetit Korçë dhe projekti për kanalizimin e ujërave të përdorura. Ngritja e impiantit të pastrimit te tyre.	Fillim Korriku 2005 deri 3 vjet	KFW	25 milion Euro	Zgjidhja një herë e përgjithmonë e problemit të ujërave të përdorura. Krijimi i kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare në qytet.
Fusha e grumbullimit të plehrave jashtë kontrollit.	Rehabilitimit të fushës së grumbullimit të mbetjeve; Pyllëzimi sipas standarteve europiane, siç janë normat e rehabilitimit si: mbulimi, dekompozimi dhe kontrolli periodik i saj.	* * * Afat shkurtër	Donatorët	15.000.000.000	Pastrim i mjedisit përreth dhe në qytetin e Korçës. Parandalimi i djegies së mbetjeve në kushte të papërshtatshme sanitare. Mbrojtja e shëndetit të qytetarëve. Mbrojtja e ujërave nëntokësore nga ndotja (burimi kryesor i furnizimit të zonës me ujë të pijshme).
Mbetjet urbane: Mungesa e pastrimit në zonat e reja të banuara Mungesa e pastrimit në rrugët dhe sheshet në borë e akull Mungesa e vlerësimit të mbetjeve të biznesit prodhues dhe të ndotjeve që shkaktojnë ata Mungesa e riciklimit ose ripërdorimit të mbetjeve Mungesa e pajisjeve praktike, estetike të grumbullimit të përkohshëm (1 ditor) të mbetjeve shtëpiake në rrugët tradicionale, në lagjet 1,2,3,11,12	Projekti Rajonal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.	* * * Afatshkurtër	KFW Donatorë të tjerë	20 milion Euro + kostoja për sistemin e menaxhimit të mbetjeve në qytet	Krijimi i kushteve moderne të menaxhimit të mbetjeve në qytet dhe krijimi i një kulture mjedisore për mbajtjen pastër të qytetit. Krijimi i alternativave mjedisore në qytet.

Zonat e gjelbra					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati Kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosotoja (lek)**	**Efekti**
Mungesa e infrastrukturës në parqet periferike si Parku Rinia dhe kodrat Belvedere	Ndërtimi i rrjetit rrugor si rrugica të brendshme, stola dhe pjergullata, vepra arti, mbjellje pemë dhe shkurre dekorative.	* * * Afatmesëm	Bashkia Korçë, Donatorët, Komuniteti	9.000.000	Përmirësimi i peizazhit rrethues dhe rritja e efektivitetit të shfrytëzimit nga komuniteti. Rritja e vlerave turistike dhe tërheqëse të qytetit.
Mungesa e infrastrukturës në parqet ekzistuese	Ndërtimi i rrugëve dhe rrugicave, tapete bari, stola dhe vepra arti, basene e shatërvanë, ndriçim dekorativ	* * * Afatshkurtër	Bashkia Korçë, Donatorë, Komuniteti,	8.000.000	Përmirësimi i peizazhit. Rritja e mjediseve çlodhëse për komunitetin.
Boshllëqe të bimësisë me drurë dekorativë në rrugët ekzistuese dhe mungesat në mbjelljet e rrugëve të reja.	Mbjellja e pemëve dhe shkurreve dekorative dhe kompozimi i tyre.	* * * Afatshkurtër	Bashkia Korçë, Donatorët	7.000.000	Pastrimi i ajrit dhe ulja e efektit të ndotjes së ajrit. Përmirësimi i peizazhit. Krijimi i një qyteti më tërheqës.
Mungesa e parqeve dhe lulishteve në bllok pallatet ekzistuese dhe në ato që do të ngrihen të rinj.	Ndërtimi i lulishteve të reja me pemë dhe shkurre dekorative, stola, fusha sportive dhe ndriçimi i tyre.	* * * Afatshkurtër	Bashkia Korçë, OJF të ndryshme,	5.000.000	Krijimi i mjediseve çlodhëse dhe argëtuese për komunitetin.
Dëmtimi i veprave të artit. Dëmtime në monumen-tet e kulturës, bordura rrugësh, stola, shatërvanë, etj.	Përmirësime dhe rehabilitime të këtyre veprave të artit, ndriçimi i tyre. Mbrojtja e tyre.	* * * Afatshkurtër	Bashkia Korçë, OJF	4.000.000	Përmirësimi estetik i qytetit Korçë.
Mungesa e një brezi të gjelbëruar izolues në varrezat e qytetit.	Mbjellje dhe përmirësim i pemëve dhe shkurreve dekorative.	* * * Afatmesëm	Bashkia Korçë, Donatorë	3.000.000	Përmirësimi i kësaj zone të qytetit Korçë. Krijimi i mjediseve të përshtatshme për komunitetin

Ajri dhe Shëndeti					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosto**	**Efektet**
Ndotja e mjedisit, tokës dhe rrezik për ndotjen e ujërave nëntokësore në zonën e vendburimeve të ujit të pijshëm të qytetit të Korçës, fshati Turan.	Monitorimi i puseve të vendburimeve të ujit të pijshëm Turan, në mënyrë periodike për treguesit kimiko-bakteriale. Monitorimi i tokës rreth këtyre puseve për treguesit bakterialë, parazitare e kimike. Zgjidhja e problemit duke larguar tregun e bagëtive të gjalla nga ky territor në një zonë tjetër më të përshtatshme. Pajisja me aparat për matjen e ujërave në terren.	* * * Brenda vitit 2005 e në vazhdim	Bashkia Korçë, Komuna Turan, UKKO, DKSHP	10 milion lekë Aparati matës 300.000 lekë	Ndalohet ndotja e mëtejshme e tokës në zonën e vendburimeve të ujit të pijshëm Turan dhe minimizohet ndotja e ujërave nëntokësore, duke mbrojtur shëndetin e konsumatorëve.
Ndotje e tokës dhe e ujërave sipërfaqësore, rrezik për ndotje e ujërave nëntokësore si pasojë e dëmtimit të kanalizimeve të ujërave të përdorura të qytetit apo derdhjeve të tyre në ujërat e përroit të Drenicës, Barçit dhe lumit të Dunavecit të patrajtuara paraprakisht.	Rikonstruksioni i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza të qytetit të Korçës dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujërave të zeza në zonën e ish-fusha druve, pranë varrezave të francezëve, zona industriale e Korçës, zona përgjatë përroit të Drenicës duke eleminuar derdhjet e tyre në përrua.	* * * Afat shkurtër	Bashkia Korçë, UKKO, Donatorë	Projekti në total 60 milion Euro	Evitohet ndotja e mëtejshme e tokës dhe e ujërave sipërfaqësore, minimizimi i ndotjes së ujit të pijshëm, ulje të sëmundshmërisë sidomos të çrregullimeve gastro-intestinale, salmonela, dizenteri, hepatit si dhe ulje të sëmundjeve të karakterit parazitar (helmintoza).
Vaditja e perimeve me ujërat e përdorura të qytetit të Korçës.	Bashkimi i grykëderdhjeve të ujërave të zeza të qytetit, shmangie e kalimit të tyre në zonat e mbjella me kultura bujqësore, zarzavate dhe realizimi i ngritjes së impiantit te trajtimit të ujërave të zeza përpara derdhjes së tyre në lumin e Dunavecit.				

Ekzistenca e fushës së grumbullimit të mbetjeve urbane në zonën afër qytetit të Korçës mbi pellgun ujëmbajtës.	Mbyllja e aktivitetit të fushës ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve urbane të qytetit te Korçës dhe studimi e përcaktimi i vendit për ngritjen e një fushe të re për grumbullimin dhe përpunimin e këtyre mbetjeve. Moslejimi i shfrytëzimit të mbetjeve në fushën ekzistuese si ushqim për bagëtitë e kryesisht për derrat që janë prezente në këtë fushë.	* * * Afat shkurtër	Bashkia Korçë, Qarku Korçë, Sipërmarrësi i përpunim pastrim të mbetjeve të qytetit, Donatorë	30 milion euro	Përmirësohet situata mjedisore, minimizohet ndotja e ajrit nga shpërbërja e mbetjeve organike në ajër dhe djegia e tyre. Minimizohet ndotja e pellgut ujëmbajtës të qytetit të Korçës, rritet garancia e mbrojtjes së shëndetit të situatës.
Djegia e mbetjeve spitalore në mënyrë primitive në territorin brenda spitalit. Në disa raste pranitë e mjeteve manipuluese si shiringat në territorin e zonës së Shetros. Ankesa nga komuniteti rreth spitalit për çlirim të gazrave dhe ndotësve të tjerë si pasojë e djegies së këtyre mbetjeve.	Ndërtimi i një inceneratori modern për djegien e mbetjeve spitalore të rrezikshme të spitalit të qytetit Korçë.	* * * Afat shkurtër	Bashkia Korçë, DSHP, Drejtoria e Spitalit Korçë, Donatorë	2 milion euro	Përmirësohet situata mjedisore, ulje te sëmundshmërisë së hepatitit, profilaksi kundër HIV/AIDS, minimizimi i ndotësve të ajrit rreth territorit të spitalit.
Ndotja e ajrit të qytetit të Korçës nga pluhurat e rrugëve, kryesisht nga LGS dhe PM10.	Ndërtimi i një plani për shtimin e sipërfaqeve të asfaltuara në qytet. Minimizimi i rrugëve me gurë dhe shesheve të pashtruara në afërsi të pallateve të banimit.	* * 2005 e në vazhdim	Bashkia Korçë, Sipërmarrja e pastrimit të qytetit, ARM, DKSHP	Asfaltim, 5 milion euro/vit	Ulje të niveleve të LGS dhe PM10 brenda normave të OBSH. Ulje të sëmundjeve të syve, të rrugëve të sipërme respiratore.

Ndotja e ajrit nga emetimet e çliruara nga automjetet dhe kaldajat e minifabrikave	1. Ngritja e cilësisë së pastrimit të qytetit, fuqizimi me mjete larëse të rrugëve nga pluhurat. 2. Realizimi i monitorimit të ajrit të qytetit kryesisht për ndotësit e çliruar nga automjetet, kaldajat e minifabrikave për CO, NOX, SO2, O3. monitorimi i ndotësve që vijnë nga pluhurat e rrugëve LGS dhe PM10. 3. Sigurimi i aparatit monitorues, aparat për marrjen e mostrave të ajrit, pompë thithëse, reagent, etj. Vënia në punë e aparatit matës të ndotësve të çliruar nga mjetet e transportit, duke larguar nga qarkullimi mjetet që çlirojnë mbi normë.	* * Afat shkurtër	Bashkia Korçë, Zyra e Urbanistikës ARM, Biznesi, DKSHP Donatorë	1) 80.000 Euro 2 mjete larëse 2) 800.000 lek 3) Aparat gaz kromatograf 50.000 Euro Aparat absorbues atomik për ajrin dhe ujin 50.000 euro	Njohja e saktë e situatës së ndotjes së ajrit, mundësi për realizimin e ndërhyrjeve afatshkurtra dhe afatgjata në zbutjen e ndotjes së ajrit në zonat e banuara të qytetit. Minimizimi i çlirimit të ndotësve kryesisht të ajrit CO_2, CO, SO_2, NO_X, nga lëndë djegëse, ulje të numrit të rasteve me sëmundje të rrugëve të sipërme respiratore, rinofaringitë, trakeitë, bronkitë, asme bronkiale, etj.
Mungesa e një sistemi bashkëkohor për ngrohjen e banesave	Parashikimi i sistemit ngrohës që në fazën e projektimit të godinave të reja. Përdorimi i sistemeve ngrohëse qendrore me lëndë djegëse që çlirojnë pak ndotje, kryesisht me gaz natyror dhe parashikimi i ndërtimit të kapave tym thithëse për të gjithë kaldajat që do të ndërtohen.	* * * Afatmesëm	Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Gjelbërimit, ARM, DKSHP Donatorë	Koordinim ndërinstitucional	Ul në mënyrë të ndjeshme ndikimin në mjedis, si rezultat i minimizimit te përdorimit të energjisë elektrike, druve dhe metodave të tjera të ngrohjes. Krijon kushte me moderne jete dhe shëndeti.

Ndotja akustike.	Evidentimi i ndotjes nga zhurmat në qytetin e Korçës. Monitorimi i burimeve kryesore të zhurmave në mjedise të jashtme dhe të brendshme, kryesisht nga gjeneratorët, lokalet dhe industria. Pajisja e Bashkisë dhe DKSHP me aparat për matjen e zhurmave. Shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara.	* * Afatshkurtër	ISHP ARM Bashkia Korçë	400.000 lek	Përmirësimi i situatës mjedisore. Ulje të çrregullimeve neurotike të shkaktuara nga zhurmat dhe incidencë më e ulët për sëmundje të veshit të mesëm me pasojë humbje të dëgjimit. Ulje e stresit në mjedis.
Tregtimi i produkteve blegtorale si djathë, gjizë, vezë në kushte jo të mira higjieno-sanitare.	Rikonstruksioni i tregut të qytetit të produkteve blegtorale, krijimi i mjediseve higjieno-sanitare për tregtimin e djathit, gjizës, vezës. Vendosja e banakëve frigoriferikë në treg.	* * * Afatshkurtër	Bashkia Korçë, DBU, Donatorë, DKSHP	50.000 euro	Krijimi i kushteve më të mira higjieno-sanitare të tregut të produkteve blegtorale të qytetit Korçë. Siguri ushqimore në nivele më të larta, ulje të infeksioneve nga helmimet ushqimore dhe minimizim i shfaqjes të rasteve të reja me brucelozë te banorët e qytetit të Korçës.
	Monitorimi periodik i produkteve blegtorale për evidentimin e brucelës në këto produkte. Sigurimi i aparaturës dhe reagentëve për këtë qëllim.	* * * Afatshkurtër		5.000 euro	

Edukimi – Infrastruktura shkollore					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosto**	**Efektet**
Mungesa e materialeve të shkruara për edukimin mjedisor	Publikim materialesh të shkruara. Botim librash për edukimin dhe përshtatja e praktikave si në qytet të tjera të Shqipërisë (Libri "Mjedisi në qytetin tim", për shkollat e Tiranës)	* * * Afatmesëm	Autoritetet arsimore Donatorë OJF	300.000	Krijimi i kushteve për rritjen e brezave, me dijet dhe kulturën e duhur për të respektuar mjedisin duke kontribuar për të ardhmen e qytetit.
Mungesa e pajisjes së mësuesve me konceptet e reja mjedisore dhe zhvillimit të qëndrueshëm	Organizimi i seancave trajnuese dhe shkëmbimit të eksperiencave me mësues të qyteteve të ndryshme	* * * Afatmesëm	OJF, Drejtoria Arsimore	300.000	Rritja e aftësive të mësuesve në fushën e mjedisit, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e ndërgjegjes mjedisore dhe krijimit të brezave me kulturë më të gjerë në mbrojtjen e vlerave komunitare dhe natyrore
Mungesa e programeve mjedisore.	Përmirësimi i programeve mjedisore. Futja e orëve mjedisore dhe krijimi i grupeve për ndërmarrjen e aktiviteteve mjedisore në shkolla	* * * Afatmesëm	Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria Arsimore	2.000.000	Futja e orëve alternative, duke rritur interesin e nxënësve për të mësuar më shumë rreth natyrës dhe kulturës mjedisore.

Edukimi – Qendrat e informimit publik					
Mungesa aktiviteteve të informimit të publikut	Krijimi i emisioneve të mirëfillta televizive Përgatitja e materialeve informuese si postera, fletëpalosje, etj., nga aktorët që punojnë në këtë fushë Krijimi i traditave të organizimit të takimeve të hapura me publikun	* * * Afatmesëm	Autoritetet vendore OJF-të Aktorë të tjerë	500.000	Rritja e ndërgjegjes qytetare për respektimin e mjedisit. Përfshirja e publikut në vendimmarrje, duke rritur dhe interesin e tij të drejtpërdrejtë në përmirësim dhe mbrojtje.
Mungesa e qendrave të informimit dhe materialeve informuese për vizitorët dhe për vetë komunitetin	Ngritja e qendrave të informimit në qytet	* * Afatmesëm	Pushteti vendor Biznesi Donatorë	5.000.000	Krijimi i kushteve për komunitetin për t'u informuar për zhvillimet në qytet. Rritja e cilësisë së shërbimit ne qytet për turistët.
Edukimi – Roli i OJF-ve					
Numri i pakët i OJF-ve mjedisore.	Nxitja e krijimit të OJF-ve mjedisore	* * Afat mesëm	Komuniteti Donatorët	1.000.000	Përfitim më i madh për komunitetin dhe qytetin, si rezultat i rritjes së aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe thithjes së fondeve për përmirësimin e mjedisit.
Mungesa e aktiviteteve të vazhdueshme mjedisore	Aktivitete të ndryshme në ditët mjedisore Ekskursione mjedisore në natyrë Konkurse mjedisore nëpër shkolla Demonstrime konkrete me nxënësit e shkollave për përmirësimin e mjedisit	* * Afat mesëm	Pushteti vendor Drejtoria Arsimore, OJFtë	3.000.000	Rritja e ndërgjegjes qytetare dhe krijimi i traditave mjedisore për mbajtjen pastër të qytetit. Duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në tërheqjen e vizitorëve.

Trashëgimia kulturore, mundësitë e zhvillimit të turizmit në qytet					
Problemi	**Aktiviteti**	**Prioriteti Afati kohor**	**Organet përgjegjëse**	**Kosto**	**Efektet**
Objekte historike të pa mbrojtura dhe të pamenaxhuara. Institucione kulturore në një nivel jo bashkëkohor.	Identifikimi i zonave dhe ndërtesave historike, kulturore që duhen të mbrohen dhe marrja e masave për këtë qëllim. Sensibilizimi i popullsisë për ruajtjen, mbrojtjen e vlerave dhe traditës. Realizimi i një guide kulturore apo hartë ku të paraqiten qendrat kulturore, pikat turistike, personalitetet më të spikatura të traditës, etj.	* * * Afatshkurtër	Instituti i Monumenteve të Kulturës. Bashkia Donatorë	30.000.000	Ruhen vlerat historike, kulturore dhe arkeologjike duke siguruar një menaxhim sa më efektiv të këtij fondi kulturor.
Mungesa e paketave turistike	Identifikimi i kërkesave të turistëve të huaj dhe vendas që do të ndihmojnë në hartimin e paketave turistike. Plan veprimi për koordinimin e aktiviteteve të agjencive dhe njësive akomoduese të turistëve.	* * * Afat shkurtër	Agjencitë private Njësitë akomoduese Bashkia	7.000.000	Krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit dhe rritjen e fluksit të turistëve.
Menaxhim jo profesion-al i hoteleve dhe njësive të tjera akomoduese, mungesa e restoranteve tradicionale.	Të identifikohen tregjet kryesore turistike duke hequr dorë nga spontaniteti. Të përmirësohen standardet e akomodimit dhe shërbimeve në to duke ruajtur tradicionalen të gërshetuar me modernen. Të rritet cilësia e ushqimit dhe shërbimit në restorante duke nxjerrë më në pah vlerat tradicionale.	* * * Afatshkurtër	Biznesi privat Shoqata e hoteleve Bashkia	E përballuar nga vetë biznesi	Siguron përmirësimin e shërbimit në njësitë turistike duke mundësuar rritjen e numrit të turistëve.

Shtojcat


Zona muze sipas planit rregullues
siperfaqe 189 440 m2
Zona muze propozuar shtese
siperfaqe 83 200 m2

PLANI I PERGJITHSHEM RREGULLUES
(SKEMA E ZONIMIT FUNKSIONAL)



a- Varreza
b- Parku
c- Infrspec
d- Tokbujqesore
e- Ekonomike
f- Fidekzis
g- Fidpersp
h- Spitalore
i- Hoteliere
j- Lulishte
k- Universitare
l- Zoneqendobjek
m- Sportive
n- Zonemuze
o- Indust
p- Perspekind
q- Perspektive
r- Banim
s- E mbrojtur

94 HA
ZONE E INDUSTRIALE
KTHEHET NE ZONE TE PERZIERE
20.2 HA
ZONE FIDANISHTE+PULARI-SERA+TOKE BUJQESORE
KTHEHET NE ZONE TE PERZIERE
13.9 HA
TOKE BUJQESORE
KTHEHET NE ZONE BANIMI
36 HA
ZONE E INDUSTRIALE
KTHEHET NE ZONE BANIMI
16.5 HA
ZONE HOTELIERE+PARKU
KTHEHET NE ZONE BANIMI

Tabela 1: Monitorimi laboratorik i cezmave të dherit

Dt.marrjes mostrës	Vendi marrjes	Era	Shija	Turbullira	NH4	NO2	NO3	Temperatura	pH	Lënde organike	Cl2	Fortësia	Ca	MPN/100ml
12.03.'03	Rr.P.Xhamballo	N	N	N	0	0	0.08	-	-	-	-	-	-	0
18.03.'03	Rr. P.Shamo	N	N	N	0	0	0.8	-	-	-	-	-	-	0
18.03.'03	Ish F. e Corap	N	N	N	0	0	1.3	-	-	-	-	-	-	0
18.03.'03	Rr. N.Kovaci	N	N	N	0	0	1.3	-	-	-	-	-	-	0
18.03.'03	Cezma Hamzës	N	N	N	0	0	1.3	-	-	-	-	-	-	0
24.04.'03	Shën Maria	N	N	N	0	0	0.02	-	-	-	-	-	-	
15.05.'03	Cezma kristali	N	N	N	0	0	0.09	-	-	-	-	-	-	
08.07.'03	Rr.P.Xhamballo	N	N	N	0	0	0.1	-	-	-	-	-	-	0
08.07.'03	Cezma Sporti	N	N	N	0	0	0.08	-	-	-	-	-	-	0
09.07.'03	Cezma Papallambros	N	N	N	0	0	0.2	-	-	-	-	-	-	240
09.07.'03	Cezma Hamzës	N	N	N	0	0	0.3	-	-	-	-	-	-	0
11.07.'03	Ish F. Corapeve	N	N	N	0	0	1.1	-	-	-	-	-	-	0
11.07.'03	Rr. P. Shomo	N	N	N	0	0	0.8	-	-	-	-	-	-	0
06.11.'03	Rr.P.Xhamballo	N	N	N	0	0	0.9	12	6	0.56	35.4	20.8	80.1	0
06.11.'03	Rr. P. Shomo	N	N	N	0	0	0.8	12	6	0.56	35.4	19.1	76.1	3
06.11.'03	Cezma Shetros	N	N	N	0	0	0.9	12	6	0.64	14.1	15.9	94.1	4
07.11.03	Cezma Sporti	N	N	N	0	0	0.08	12	6	0.8	31.9	21.1	80.1	3
07.11.03	Cezma Radanec	N	N	N	0	0	0.3	12	6	0.88	24.8	24.5	30.6	0
07.11.03	Cezma Papallambro	N	N	N	0	0	0.2	12	6	0.96	24.8	7.7	31.06	7
07.11.03	Ish F. Corapeve	N	N	N	0	0	1.1	12	6	0.72	28.3	21.8	34.06	0
07.11.03	Shën Mëria	N	N	N	0	0	0.02	12	6	0.82	10.6	11.2	12.02	0
15 09 04	papallambro	N	N	N	0	0	0.3	12	6	0.95	24.8	7.8	31.1	0
15 09 04	Rr P.XHamballo	N	N	N	0	0	0.9	12	6	0.56	35.4	20.8	80.0	0
15 09 04	Ish F.Corapeve	N	N	N	0	0	1.1	12	6	0.78	31.9	21.1	80.1	0
15 09 04	Shen Meria	N	N	N	0.02	0.03	0.2	12	6	0.82	10.6	11.2	12.0	0
15 09 04	Rr P.Shomo	N	N	N	0	0	0.8	12	6	0.56	35.4	19.1	76.1	0

Tabela 2: Monitorimi i ujit të lumit Dunavec

Nr.	Dt.marrjes mostrës	Vendi marrjes	Temp. mjedisit	Temp. ujit	pH	Lënde në suspencion	NH4	Turbullimë	Lëndët organike	Mbetje e thate	Kloruret	Alkaliniteti mg ek/litër	MPN/100ml
1	17.04.03	Vendi italianëve	14oC	13oC	6	0	0	Turbullt	2.56	0.25	7.092	1.4	Mbi 2400
2	17.04.03	Tek ura	14oC	13oC	6	0	0	"	2.56	0.25	7.092	1.4	Mbi 2400
3	17.04.03	Pas kaskadësI	14oC	13oC	6	0	0	"	2.72	0.13	7.09	1.4	Mbi 2400
4	17.04.03	Afër pusit fundit	14oC	13oC	6	0	0	"	0.72	0.26	7.092	1.4	Mbi 2400
5	21 03 .05	Afër urës Fajancës	10oC	8oC	6	0	0.03	"	2.56	0.04	10.5	1.4	240
6	21.03 05	Afër urës Bulgarecit	10oC	8oC	6	0	0.07	"	2.48	0.05	12.2	1.4	21000

Tabela 3: Monitorimi baktereologjik dhe fiziko-kimik i puseve të Turanit

Nr.	Dt.marrjes së mostrës	Nr. pusit	Era	Shija	Turbullira	Lëndët organike	NH4	NO2	NO3	Ngarkesa mikrobike MPN/ 1000ml
A	26.08.2003	501	N	N	N	1.72	0	0.01	1.2	0
	26.08.2003	502	N	N	N	0.64	0	0.5	1.2	0
	26.08.2003	504	N	N	N	0.64	0	0	1.2	0
	26.08.2003	505	N	N	N	4	0	0.01	1.2	0
B	01.09.2003	501	N	N	N	1.72	0	0.01	1.3	-
	01.09.2003	502	N	N	N	0.64	0	0.3	1.3	-
	01.09.2003	505	N	N	N	0.6	0	0.01	1.12	-
C	12 01 2005	501	N	N	N	1.70	0	0.02	1.3	0
	12 01 2005	502	N	N	N	0.72	0	0.6	1.2	0
	12.01 2005	504	N	N	N	0.65	0	0.02	1.1	0
	12 01 2005	505	N	N	N	3.4	0	0.03	1.3	0

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË

VENDIM

NR. 69 DATË 8.11.2005

PËR

MIRATIMIN E "PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS"

Këshilli i Bashkisë së qytetit Korçë, i mbledhur në datën e sotme, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Sektori i Koordinim- Zhvillimit dhe Marrëdhëniet me Jashtë, mbi miratimin e "Planit Lokal të Veprimit në Mjedis, si dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve, duke u bazuar në Ligjin nr. 8652 dt. 31. 07. 2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore ", Neni 11, pika d dhe Neni 32, pika k.

VENDOSI:

1. Të miratojë "Planin Lokal të Veprimit në Mjedis", sipas materjalit të paraqitur në Këshillin e Bashkisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Koordinim-zhvillimit dhe Marrëdhëniet me jashtë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

GJERGJI MERO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA KORÇË

Marjanii
Korce